



**Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova**  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

## **KUVENDI I KOMUNËS KOMITETI PËR KOMUNITETE**

### **PLANI I PUNËS PËR VITIN 2019**

**Podujevë, janar 2019**

Komiteti për Komunitete, në vitin 2019, angazhimin punët dhe aktivitetet do t'i fokusoj në përmbushjen e obligimeve dhe përgjegjësisë mbi bazën e dispozitave ligjore, akteve nënligjore dhe detyrave të përcaktuara me këtë Plan, në veçanti:

- Implementimi i Strategjisë së Qeverisë së Republikës së Kosovës për integrimin e komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptas.
  - Detyrë e përhershme.
- Mbikëqyrja në mënyrë të drejtpërdrejtë në realizmin e plotë të të drejtave, lirive dhe interesave të bashkësive etnike që jetojnë në territorin e Komunës së Podujevës.
  - Detyrë e përhershme.
- Angazhim në ruajtjen dhe mbrojtjen e identiteteve dhe vlerave etnike , kulturore, fetare , mendimit politik dhe çfarëdo mendimi tjetër pavarësisht nga përkatësia etnike.
  - Detyrë e përhershme.
- Avancimi i marrëdhënieve të mira ndëretnike.
  - Detyrë e përhershme.
- Rekomandime të masave, organeve përkatëse, për çështje për të cilat gjatë punës dhe aktiviteteve vlerëson se janë të nevojshme në realizmin e plotë të të drejtave të garantuara ligjore si dhe dispozitave të Konventave përkatëse ndërkombëtare.
  - Detyrë e përhershme
- Përcjellja e vazhdueshme e institucioneve të Komunës në aspektin e respektimit të dispozitave ligjore , politikat dhe praktikat e Komunës si dhe aktivitetet në realizmin e plotë të të drejtave të bashkësive etnike.
  - Detyrë e përhershme
- Kujdesi i vazhdueshëm që në Komunë gjuhët zyrtare të jenë në përdorim të barabartë për pjesëtarët e të gjitha bashkësive etnike, të kenë status të njëjtë në punët dhe aktivitetet e organit përfaqësues dhe organit të Ekzekutivit të Komunës si dhe që çdo qytetarë të ketë të drejtën e shprehjes së lirshme pran institucioneve të Komunës në gjuhët dhe alfabetet zyrtare.
  - Detyrë e përhershme

- Kujdesi për respektimin e mënyrave , procedurave dhe kushteve për përfshirjen dhe pjesëmarrjen e të gjithë pjesëtarëve të komuniteteve në proceset e vendimmarrjes, planifikimeve dhe përgjegjësitë në kuadër të kompetencave të Komunës.
  - Detyrë e përhershme
  
- Kujdesi për përmbushjen e obligimeve dhe përgjegjësi të Kuvendit të Komunës, trupave të Kuvendit dhe Ekzekutivit të Komunës për punë transparente dhe krijimin e mundësive dhe mekanizmave për informim të mirëfilltë të pjesëtarëve dhe subjekteve të të gjitha komuniteteve, për punët dhe aktivitetet e përditshme të Kuvendit të Komunës, trupave të Kuvendit dhe Ekzekutivit në përgjithësi.
  - Detyrë e përhershme
  
- Shqyrtimi i të gjitha propozim Rregulloreve dhe akteve tjera të përgjithshme të cilat procedohen për miratim në Kuvendin e Komunës.
  - Detyrë e përhershme
  
- Shqyrtimi i të gjitha kërkesave dhe ankesave të cilat i drejtohen këtij Komiteti.
  - Detyrë e përhershme
  
- Shqyrtimi propozimit të Planit të punës për vitin 2019.
  - ❖ Maj 2019
  
- Vizitë e komuniteteve pakicë në rrugën “Xhafer Meta” në Podujevë.
  - ❖ Qershor 2019
  
- Vizitë e komuniteteve pakicë në rrugën “Ali Ajeti” në Podujevë.
  - ❖ Qershor 2019
  
- Vizitë e komuniteteve pakicë dhe shkollës fillore në fshatin Batllavë dhe Orllan.
  - ❖ Qershor 2019
  
- Informatë për përfundimin e vitit shkollor 2018/2019 me theks në suksesin dhe vijueshmërinë e nxënësve të komuniteteve ashkalinj dhe rom.
  - ❖ Korrik 2019
  
- Identifikimi i nxënësve të komuniteteve pakicë të cilët eventualisht e kanë ndërprerë shkollimin dhe ndërmarrja e veprimeve për përfshirjen e tyre në procesin mësimor

- Identifikimi i personave të komuniteteve pakicë të cilët e kanë ndërprerë shkollimin e mesëm dhe ndërmarrja e veprimeve për përfshirjen e tyre në procesin mësimor joformal për përfundimin e klasave përkatëse
  - ❖ Korrik 2019 (java e parë)
- Informatë për fillimin e vitit shkollor 2019/2020, gjendja aktuale e nxënësve të komuniteteve ashkalinj dhe rom dhe egjiptas, sfidat dhe vështirësitë
  - ❖ Shtator 2019
- Vizitë e komuniteteve pakicë dhe shkollës fillore në fshatin Orllan.
  - ❖ Shtator 2019
- Vizitë në shkollat fillore të Mesme të Ulëta: “Naim Frashëri” dhe “Shaban Shala” në Podujevë
  - ❖ Tetor 2019
- Shqyrtimi i mundësive për gjetjen e donatorëve eventual për sigurimin e lëndës djegëse për ngrohje gjatë dimrit për familje me nevojë të komuniteteve pakicë.
  - ❖ Tetor 2019
- Analizë e realizimit të Planit të punës të Komitetit për Komunitete për vitin 2019, çdo tre muaj.
- Shqyrtimi i Informatave të Zyrës komunale për komunitete dhe kthim, sipas nevojës.
- Shqyrtimi i realizimit të rekomandimeve të këtij Komitete, drejtuar strukturave relevante të nivelit lokal dhe nivelit qendror, çdo tre muaj.
- Në funksion të shkëmbimit të përvojave me Komitetet e Komuniteteve, vizita në komunat e Republikës së Kosovës:
  - Komuna e Prizrenit,
  - Komuna e Mitrovicës së Jugut,

Kryesuesi i Komitetit për Komunitete, në bashkëpunim dhe koordinim me anëtarët e Komitetit i cakton datat e vizitave sipas këtij plani.

### **Bashkëpunimi**

Komiteti për Komunitete, gjatë vitit 2019, në vazhdimësi do të bashkëpunoj dhe aktivitetet do t'i bashkërendoj , me :

- Institucionet relevante të Komunës, në veçanti me Zyrën për Komunitete dhe Kthim
- Ministrinë për Komunitete dhe Kthim
- Kabinetin e Kryeministrit - Zyrën për Komunitete
- OSBE-në,
- KFOR-in,
- Njësitin për komunitete të Stacionit të policisë në Podujevë,
- Policinë rajonale kufitare Veriu në Lluzhan,
- Ekipet vepruese për siguri në bashkësi të Komunës së Podujevës,
- OJQ-të e ndryshme, për mbështetje në implementimin e Strategjisë së Qeverisë së Republikës së Kosovës për integrimin e komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptas
- Subjektet tjera relevante

### **Mbledhjet**

Komiteti për Komunitete do të mbajë mbledhje sipas nevojës dhe së paku një mbledhje gjatë çdo muaji.

**Podujevë,  
05 shkurt 2019**

**Kryesuesi i Komitetit  
Xhafer Ademi**